



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë; Tel-Fax: 04-228485

Nr.798/6 Prot.

Tiranë, më 12/12/2017

V E N D I M

Nr.166, Datë 12/12/2017

PËR

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË SELENICË ME OBJEKT "MBI
AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË DATËS 31.12.2016"**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori dhe Kryeaudituesi i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve të Auditimit dhe Etikës si dhe Drejtori i Përgjithshëm, nisur nga fakti se nga auditimi financiar i ushtruar në Bashkinë Selenicë janë konstatuar parregullsi, devijime materiale por jo të përhapura, për të cilat jemi shprehur në Raportin e Auditimit bashkëlidhur, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

VENDOSA

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Mbi auditimin e pasqyrave financiare të datës 31.12.2016" të ushtruar në Bashkinë Selenicë, sipas programit të auditimit nr. 798/1 prot, datë 24.07.2017.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

A. OPINIONI I AUDITUESIT

Opinion i kualifikuar

Përgjegjësia e Audituesit të KLSH-së, është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindjet, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e ndërtimit të pasqyrave financiare dhe Raportimit Financiar. Sipas mendimit tonë, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, mbështetur në standardet ISSAI 1700¹ dhe ISSAI 1200² shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të Bashkisë Selenicë, duke arritur në përfundimin se anomali apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në periudhën nën auditim. I njëjti opinion vlen edhe për pasqyrën e realizimit të buxhetit.

Duke marrë në konsideratë faktin se subjekti i audituar mund të mos arrijë në kuptimin e saktë të opinionit mbi pasqyrat financiare, duam të tërheqim vëmendjen për anomali me ndikim të dukshëm mbi nivelin e materialitetit, dhe që kanë ndikim në vendimmarrjen e përdoruesve të pasqyrave financiare.

Kemi konstatuar se llogaria e aktivit “Toka, troje, Terrene” e paraqitur në vlerën 140,307,952 lekë, nuk pasqyron vlerën e saktë të trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë Selenicë. Vlera e kësaj llogarie i referohet vlerësimit të bërë nga Drejtoria e Financës bazuar në çmimin e shitjes së trojeve publike sipas Zonave Kadastrale, pa vendimmarrjen e një komisioni të ngritur nga Titullari i Institucionit. Nuk ka informacion të statusit juridik të këtyre pronave në terren. Aktivitetet e këtij grupi nuk janë regjistruar në ZVRPP në pronësi të Bashkisë Selenicë. Në këtë llogari, nuk janë përfshirë asetet që me VKM kanë kaluar në pronësi të ish Komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë Selenicë.

Gjatë vitit, janë marrë në administrim nga U.....i Sh.A, asete të Bashkisë Selenicë në vlerën kontable për 526,501,279 lekë. Kalimi i këtyre aktiveve është bërë sipas urdhrit të Kryetarit të Bashkisë nr.1321, datë 15.07.2016 “Për krijimin e komisionit për kalimin e aseteve të ish komunave Sha U..... t Selenicë”. Për këto vlera inventare, nuk janë bërë veprimet kontabile në pakësimin të llogarive të aktivitetit të bilancit me justifikimin se nuk është kaluar për miratim në Këshillin e Bashkisë, konkretisht sipas llogarive: Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për 515,755,627 lekë, Llogaria 214 “Instalime makineri paisje” për 9,831,852 lekë, Llogaria 218 “Inventar ekonomik” për 757,600 lekë dhe llogaria 32 “Objekte inventari” për vlerën 156,200 lekë. Kjo anomali në pasqyrimin e transaksioneve financiare, ka efekte negative si në pasqyrat financiare të Bashkisë por edhe të Ndërmarrjes U..... s K..... e sh.a.

Konstatohet se në llogaritë 423, 429 dhe 468, janë përfshirë edhe debitorët për tatim taksat lokale për vlerën 183,520,731 lekë. Nga të dhënat e Drejtorisë së Tatim Taksave

¹Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raportit të shkruar që shpjegon bazat e opinionit.

²Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

që është e ngarkuar me mbajtjen e kontabilitetit të këtyre detyrimeve, rezultoi se detyrimet progresive në vite për tatim taksat lokale janë në shumën 265,301,858 lekë. Pra diferenca e njohjes së detyrimeve ndaj Tatimeve dhe Taksave Lokale, rezulton në vlerën 81,781,127 lekë, ose 30% e detyrimeve të deklaruara nga Drejtoria e ngarkuar me ndjekjen e tyre. Në shënimet e Pasqyrave Financiare, nuk jepet informacion lidhur me angazhimet e marra përsipër si rezultat i kontratave të lidhura për vitin 2016 për punime, shërbime dhe mallra. Vlera e kontratave të pa paguara rezulton në shumën 96,862,072 lekë nga të cilat shuma për 87,717,010 lekë, i takon detyrimeve sipas kontratave të lidhura në vitin 2016.

B. MASA ORGANIZATIVE

GJETJA 1

Për të vlerësuar nivelin e sistemeve të kontrollit dhe zbatimin e kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit”, grupi i auditimit testoi disa nga komponentët që garantojnë cilësinë e kontrolleve të brendshme.

Mjedisi i kontrollit. Strukturat e Bashkisë, funksionojnë sipas detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendshme mbi: “Organizimin e veprimtarisë së punonjësve të bashkisë”, miratuar me vendim të Këshillit të Bashkisë nr. 54, datë 31.10.2012. Rregullorja nuk ka koherencën dhe nuk reflekton ndryshimet e reformës territoriale, pasi nuk ka detyra për funksionimin e 5 Njësive Administrative të krijuara sipas reformës administrative; Vllahinë, Kotë, Brataj, Sevaster dhe Armen të cilat kanë në strukturën e tyre organizative 8 deri 10 punonjës ku përfshihen inspektori i financës, inspektori i tatim taksave, inspektori i bujqësisë etj.

Nga 58 pozicione pune të parashikuara me statusin e nëpunësit civil, në fakt trajtohen me statusin e nëpunësit civil 12 punonjës, ose realizuar në masën 21% të pozicioneve të punës me statusin e nëpunësit civil.

Niveli profesional i stafeve dhe eksperiencia është e ulët, fakt që reflekton një risk të lartë operacional në përmbushjen e funksioneve dhe realizimin e objektivave të njësisë. Konstatuam se 23 punonjës me arsim të lartë kanë një përvojë pune deri në një vit në Njësinë e Qeverisjes Vendore, 35 punonjës me arsim të lartë kanë përvojë pune në institucione të tjera deri në një vit. Këto punonjës përbëjnë 75% të stafit të Bashkisë.

Nga 224 punonjës jo administrativë që ka pasur në punë Bashkia e Selenicës në vitin 2016, 155 prej tyre (ose 69%) janë punonjës me kontratë me afat, ndërsa pjesa tjetër janë punonjës me kontratë provizore.

Menaxhimi i riskut. Nga titullari i Njësive Administrative, nuk është caktuar koordinatori i riskut dhe për rrjedhojë nuk janë identifikuar sistemet e kontrollit me risk. Nuk është hartuar regjistri i riskut dhe për rrjedhojë nuk janë marrë masa për menaxhimin e tij. Aspektet e riskut nuk njihen dhe kuptohen në nivelin e duhur nga strukturat drejtuese të njësisë.

Monitorimi. Monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në përgjithësi, realizohet në mënyrë formale duke respektuar ato kritere mbi të cilat edhe raportohet pranë Ministrisë së Financave.

Në nivelin e ulët të implementimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm ka ndikuar edhe mungesa e funksionimit të auditimit të brendshëm sipas kërkesave të Ligjit “Për organizimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik”

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Të merren masat e nevojshme për implementimin e kërkesave të Ligjit nr.10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollit” i ndryshuar. Të përpilohet rregullorja e re e funksionimit të brendshëm të Bashkisë Selenicë bazuar në organizimin aktual përfshi Njësitë Administrative.

Të merren masa për ngritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore duke vendosur kritere profesionale dhe realizuar procedura konkurimi transparente.

Të caktohet koordinatori i riskut, të identifikohen aktivitete me risk dhe të merren masa për menaxhimin e tij.

Brenda Muajit Mars 2018

GJETJA 2

Buxheti i Bashkisë Selenicë për vitin 2016 është miratuar me VKB-në nr. 5, datë 18.02.2016 në kundërshtim me afatet ligjore. Të ardhura dhe shpenzimet janë programuar gjithsej për 529,779,723 lekë. Në total, treguesit e buxhetit, janë realizuar në masën 80%. Shpenzimet për investime, llogaria 230 dhe 231, janë në nivel më të ulët realizimi, përkatësisht 32% dhe 64%. Ndikim në mos realizimin e tregueseve të buxhetit, ka pasur mos realizimi i të ardhurave nga tatim taksat lokale të cilat janë programuar për 331,620,000 lekë, realizuar 53,051,837 lekë ose 16% e programimit.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Bashkia Selenicë, të marrë masat për përgatitjen e një buxheti sa më real. Të merren masa për të rritur performancën e vjeljes së të ardhurave nga tatim taksat lokale.

Menjëherë

GJETJA 3

Llogaria aktive e bilancit 202 “Studime e projekte” për vlerën kontabël 34,306,686 lekë, është e analizuar sipas llojit të projekteve dhe studimeve të financuara në vite. Nga auditimi u konstatua se administrimi i projekteve dhe studimeve, nuk është bërë bazuar në inventarizimin fizik të tyre. Vlera e projekteve dhe studimeve për të cilat kanë përfunduar objektet në terren, është në shumën 30,012,386 lekë, fakt që tregon se vlera e paraqitur në këtë zë të paësqrave financiare është e gabuar.

NIVELI I PRIORITETIT

I mesëm

REKOMANDOJMË

Të merren masat, të sistemohet llogaria 202 “Studime e projekte” bazuar në investimet e objekteve të përfunduara me qëllim për të vlerësuar saktë vlerën e investimeve të përfunduara.

Të kryhet inventarizimi i studimeve dhe projekteve që janë financuar në vite, duke përcaktuar personat përgjegjës në ngarkim të këtyre studimeve dhe projekteve.

Menjëherë

GJETJA 4

Llogaria e aktivitet të bilancit 210 “Toka, troje, Terrene” për vlerën e debisë 140,307,952 lekë, nuk pasqyron saktë vlerën e trojeve të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave janë kaluar në pronësi të Bashkisë Selenicë. Vlerësimi në lekë i trojeve, është bërë nga Drejtoria e Financës bazuar në çmimin e shitjes së trojeve publike sipas Zonave Kadastrave. Ky vlerësim, nuk është i saktë, pasi:

- Vlerësimi nuk është bërë me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit,
- Trojet dhe terrenet, janë vlerësuar pa verifikuar në terren, statusin juridik të tyre,
- Këto aseteteve, nuk janë regjistruar në ZVRPP në pronësi të Bashkisë Selenicë,
- Nuk janë inventarizuar dhe vlerësuar toka, troje, terrene të cilat me Vendime të Këshillit të Ministrave, kanë kaluar në pronësi të ish Komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë Selenicë.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Bashkia Selenicë, të marrë masa për të regjistruar asetet që me VKM kanë kaluar në pronësi të saj e më pas të bëjë vlerësimin e tyre me komisione të specializuara për efekt të saktësimin të vlerës kontabël të tyre.

Brenda Muajit Maj 2018

GJETJA 5

Llogaritë inventariale të aktivitet të bilancit, nuk paraqesin gjendjen reale të inventarëve fizikë për shumën totale 528,778,118 lekë pasi:

- Gjatë vitit, janë marrë në përdorim nga U..... i SHA, i administruar nga Bashkia Selenicë, inventarë në vlerën kontabël për 526,501,279 lekë. Kalimi i këtyre aktiveve është bërë sipas urdhrin të Kryetarit të Bashkisë Nr. 1321, datë 15.07.2016 “Për krijimin e komisionit për kalimin e aseteteve të ish komunave, U..... t SHA Selenicë”. Për këto vlera inventarë, nuk janë bërë veprimet kontabël në pakësimin të llogarive të aktivitet të bilancit për arsye se nuk është kaluar për miratim në Këshillin e Bashkisë, konkretisht sipas llogarive:

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” për 515,755,627 lekë,

Llogaria 214 “Instalime makineri pajisje” për shumën 9,831,852 lekë,

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” për vlerën 757,600 lekë dhe llogaria 32 “Objekte inventari” për vlerën 156,200 lekë.

- Sipas rezultateve të inventarizimit fizik të fund vitit 2016, konstatohen diferenca, ku llogaritë kontabël pasqyrojnë më tepër se gjendja fizike për shumën 2,276,839 lekë për të cilën nuk janë nxjerr personat përgjegjës.

- Nga inventarizimi, janë konstatuar vlera inventariale tepër për shumën 297,749 lekë për të cilën nuk janë kryer veprimet kontabël në debi të llogarive inventariale.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Nga Bashkia Selenicë, të merren masa për sistemimin e llogarive përkatëse sipas rezultateve të inventarizimeve.

Të konfirmohet me Vendim të Këshillit të Bashkisë, kalimi asetëve për “U..... s” SHA.

Brenda Muajit Janar 2018

GJETJA 6

Në llogaritë e aktivitetit të bilancit 423, 429 dhe 468, janë përfshirë edhe debitorët për tatim taksat lokale për vlerën 183,520,731 lekë. Në këtë shumë është përfshirë vlerat debitore e bizneseve si dhe debitorët për detyrimet familjarëve. Kontabiliteti i detyrimeve për Tatim Taksat Lokale, ndiqet nga Drejtoria e Tatim Taksave lokale. Vlera e pasqyruar në kontabilitet për debitorët e Tatim Taksat Lokale, nuk janë të konfirmuar nga Drejtoria e Tatim Taksave.

Nga të dhënat e kësaj Drejtorie, rezultoi se detyrimet progresive në vite për Tatim Taksat Lokale janë në shumën 265,301,858 lekë ku përfshihen 7,306 familje për taksën e tokës bujqësore, 383 biznese të vegjël dhe 17 biznese të mëdha. Në këto kushte, llogaritë debitore për shumën e detyrimeve Tatim Taksat Lokale, nuk pasqyrojnë gjendjen reale për vlerën 81,781,127 lekë (diferenca 265,301,858-183,520,731).

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Të sistemohet llogaria e gjendjes debitore për detyrimet për Tatim Taksat Lokale bazuar në gjendjen reale të debitorëve.

Pasqyrimi në pasqyrat financiare të detyrimeve debitorë, të bëhet në bazë të dhënave të Drejtorisë së Tatim Taksave të Bashkisë Selenicë, e cila ndjek edhe kontabilitetin sipas subjekteve dhe sipas familjarëve.

Për një performancë më të mirë të vjeljes së detyrimeve për tatim taksat lokale, Bashkia Selenicë, të shikojë mundësinë e caktimit si agjent tatimor të “U..... t” sha, nëse vjelja e detyrimeve për tarifën e ujit të pijshëm është më rezultateve.

Brenda Muajit Janar 2018

GJETJA 7

Gjatë vitit 2016, nga Bashkia e Selenicës, janë lidhur me subjektet fitues të tenderëve, 11 kontrata si dhe kanë qenë në proces zbatimi 3 kontrata të tjera. Vlera e kontratave të lidhura për vitin 2016, është në shumën totale 158,460,169 lekë. Në fund të vitit ushtrimor 2016, vlera e kontratave të pa paguara për mungesë fondesh, është në shumën totale 96,862,072 lekë nga të cilat shuma 87,717,010 lekë, janë detyrimet sipas kontratave të lidhura në vitin 2016.

Vlera e punimeve të përfunduara dhe të pa financuara për mungesë fondesh, nuk është kontabilizuar si detyrim, pasi subjektet sipërmarrëse, nuk kanë paraqitur situacionin e punimeve dhe faturat përkatëse.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Nga Bashkia Selenicë, të merren masat për të pasqyruar në bilanc, detyrimet për punimet e përfunduara nga subjektet sipërmarrëse por të pa financuara për mungesë fondesh, duke ju kërkuar subjekteve sipërmarrëse, paraqitjen e dokumentacionit të plotë ligjor për punimet e kryera e të pa financuara.

Brenda Muajt Janar 2018

GJETJA 8

Plani i shpenzimeve për blerje dhe shërbime (Llogaria 602) është programuar në vlerën 69,250,960 lekë, realizuar në fakt në vlerën 60,093,740 lekë ose 87 %. Nga auditimi me zgjedhje i procedurave të realizuara për blerjen e disa lloj mallrash e shërbimesh me vlera të vogla, si blerje materiale ndërtimi, blerje materiale elektrike, pjesë këmbimi, blerje ushqime, rikonstruksione të ndryshme etj. dhe kontratat e shërbimeve dhe furnizimeve, rezulton se nuk janë pasur parasysh kërkesat e përcaktuara në VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Udhëzimin APP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, nr. 2 datë 28.03.2013, ndryshuar me Udhëzimin APP nr. 5 datë 16.07.2013 dhe nr. 1, datë 28.02.2014, VKM nr. 47, datë 21.01.2013 “Për një shtesë në VKM nr. 45, datë 21.01.2009 “Për kryerjen e procedurave të prokurimit në mënyrë elektronike” i ndryshuar, pasi:

Në disa raste, është përcaktuar afati i zhvillimit të prokurimit, por në dokumentet e tenderit nuk është shënuar afati i lëvrimit të mallit apo shërbimit.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Nga Bashkia Selenicë, të merren masat e nevojshme, të procedohet sipas kërkesave ligjore në procedurat e prokurimeve me vlera të vogla. Të riorganizohet komisioni i prokurimeve për blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla.

Menjëherë

GJETJA 9

Nuk janë zbatuar plotësisht masat e rekomanduara me shkresën nr. 484/6, datë 24.07.2015 dhe të rikërkuar për tu zbatuar me shkresën nr. 1015/56 prot., datë 5.04.2016. Nga dy masa organizative të rikëruara për arkëtimin e vlerës totale 82,828,332 lekë, nga të cilat 3,408,185 lekë sipas rekomandimeve të KLSH-së nga auditimi në vitin 2012 dhe 79,420,147 lekë detyrim i krijuar nga ish Komuna Vllahinë për tatim taksa lokale të pa vjela, nuk është zbatuar asnjë masë.

Nga 4 masa të rikëruara për shpërblimin e dëmit në vlerën totale 84,121,919 lekë, nuk janë zbatuar 3 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë duke arkëtuar vlerën 611,500 lekë, ngelet pa arkëtuar diferenca për vlerën 83,510,419 lekë.

Nga dy masa administrative, ku nga KLSH i është rekomanduar Kryeinspektorit të IMTV Bashkisë Selenicë, Vlorë që të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur dënim me gjobë për 2 mbikëqyrësit dhe 2 kolaudatorët, ky rekomandim nuk është zbatuar.

NIVELI I PRIORITETIT

I Lartë

REKOMANDOJMË

Nga Bashkia Selenicë, të merren masat e nevojshme për të ndjekur me priorite zbatimin e masave që forcojnë disiplinën financiare dhe risin përgjegjshëmrinë e nënpunësve shtetërore. Këshilli i Bashkisë, të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së, që kanë cuar në parashkrimin e detyrimeve të pretenduara. Për të gjitha detyrimet e mundshme për tu rikërkuara, të vijohet me procedurat administrative dhe ligjore për të siguruar arkëtimin e shumave në buxhetin e bashkisë.

Menjëherë

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim, ngarkohet Departamenti i Auditimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R